



# ISO = POLIFONIA

MARS 2006, NR. 3

Botimi i Këshillit të Muzikës Shqiptare dhe Seksionit Shqiptar të CIOFF-it  
Realizuar në bashkëpunim me stafin e gazetës "Dita JUG"

## Isopolifonia surpriza shqiptare e Sanremos

*Kënga e Ana Oksës një baladë mes tingujve të polifonisë së lashtë dhe atyre modernë*

Kur në janar të këtij viti këngëtarja e njohur italiane me orgjinë shqiptare Ana Oksa ka zbritur në Tiranë për një vizit të shkurtër disa orëshe, askush nuk e dinte se ajo kishte sjellë me vete në Tiranë një surprizë muzikore që "do t'i dilte tymi" vetëm në skenën prestigjioze të Sanremos. Askush nuk e dinte atëherë se isopolifonia dhe Ana Oksa do të sfidonin skenën e këtij festivali muzikor me emër të madh duke promovuar kështu një nga projektet më ambicioze të bashkëpunimit multikulturor.

Pas interpretimit "Valeria" të këngëtares së talentuar shqiptare Elsa Lila në Sanremo dy vjet më parë, kënga e Ana Oksës e shoqëruar nga një grup polifonik nga Tirana janë dy eventet muzikore më të mëdha shqiptare që i kanë dhënë këtij festivali një aromë shqiptare. Çelësi i suksesit dhe ura lidhëse mes fenomenit më të vjetër të historisë dhe botës muzikore isopolifonisë dhe këngëtares së madhe me orgjinë shqiptare në këtë rast ka qenë artisti ynë i shquar Ardit Gjebrea, ndërsa garant i mbështetjes së këtij projekti ishin Ministria e Turizmit Kulturës Rinisë dhe Sporteve dhe kompania AMC.

### Vetgrykimi i Anës në Ariston

Ana Oksa e ka bërë "gryqin e vetvetes" në skenën e Aristonit. Ashtu siç edhe ishte përfolur ka bërë një performancë të vërtetë. Daljes së saj i ka paraprirë një errësirë e plotë. E më pas Oksa së bashku me grupin të ndriçuar nga një dritë e dobët. Surpriza ka marrë formën e një arie të dhimbshme. Vokali i saj ka lëvizur në ekstremet e mundshme. Nga një për-

shpëritje për veten në një britmë zgjimi. Megjithë polemikat e shumta kënga e saj nuk është shkurtuar. E shoqëruar nga grupi i këngëtarëve shqiptarë i përbërë nga Ardit Gjebrea, Armando Kllogjri, Noko Vasili, Gramoz Burba, Andrea Doçi, Bardhyl Xhafka, Hekuran Bllaca në kor, Ilir Neziri e Genc Kruja në perkuson, Alban Tahiri në violinë nën dhe Stefano Barzan drejtues i orkestrës ka kënduar në skenë për 4 minuta e 13 sekonda. Por ky përjashtim u bë vetëm për natën e parë të Festivalit. Ndryshe nga sa ishte përfolur deri në momentin e interpretimit, Oksa nuk ishte e veshur me veshje tipike shqiptare. Nuk pati as veshje të Lunxhërisë dhe as xhubletë. Kishte vetëm një fustanellë të bardhë e të hollë. Ishte zbulimi i misterit të Oxës.

### Polemikat

Kënga që Anna Oksa deshi të ruajë sekret deri në natën finale, ngjalli përveç kuriozitetit edhe reagime të shumta. Për rezervat që krijoi apo për faktin se surpriza ishte një këngë me motive shqiptare, xhelozitë e krijura te kolegët e saj nxorën krye. Nga 3 minuta e gjysëm të vëna në dispozicion për çdo këngë ajo kalonte në 4 minuta e ca.



Nga Dr. Spiro Shetuni

*Një popull i vogël mund të ketë një art të madh*



Në foto: Këngëtarja Ana Oksa dhe grupi i polifonisë "Ergjëria", në FFK Gjirokastra 2004.

Foto montazh

Kjo ishte përplasja e parë. Artistë kritikojnë faktin që këngëtares shqiptare i është dhënë një hapësirë më e gjerë. Ata që kanë kundërshtuar më fort kanë qenë këngëtarët Mario Venuti dhe Nicky Nicolai, të cilëve iu janë hequr nga një pjesë në këngët e tyre. Edhe pse çështja është kthyer kundër Oxës, gjatësia e këngës nuk ishte toleruar vetëm për të. Gianmarco

Mazzi, drejtori artistik i festivalit e ka kundërshtuar këtë gjë. Në qoftë se do t'i hiqeshin disa pjesë këngës së Annës, kjo do të ndodhte edhe për 16 këngë të tjera pjesëmarrëse. Mazzi e ka quajtur qesharake një gjë të tillë dhe në këtë rast mund të mbyllej një sy. "Oksa ka një performancë shumë befusuese, është një oper muzikore dhe nuk mund të pritet", - ka thënë ai.



Nga Sinan Ahmeti

*Profil i ansambllit polifonik "Zëri i Bilbilit" Sarandë*



Nga Sejmen Gjokoli

*Magjia e Polifonisë ka mahnitur këdo që e ka dëgjuar*

### Skualifikimi dhe misteri

Pas këtyre replikave të shumta, skualifikimi i Anna Oxës ka qenë në pikëpyetje. U ngjit të prezantojë këngën dhe u skualifikua që natën e parë. Gjithçka ka filluar vetëm pak kohë më parë kur këngëtarja me origjinë shqiptare Anna Oksa ka bërë një vizitë të shpejtë në Tiranë. U fol për një bashkëpunim, një projekt i gjerë, muzikë shqiptare etj. Pas gjithë kësaj ishte konkurimi në Festivalin e Sanremos me një këngë të shoqëruar nga një grup polifonik shqiptar. Kaq ishte si fillim edhe pse shumë pyetje ngelën pa përgjigje. Ndërkohë që për median italiane, gjithçka ishte edhe më e fshehtë. Anna Oksa nuk ka dashur dhe është përpjekur që të ruajë deri natën finale surprizat që do të ofronte me konkurimin e 13 -të të saj në Sanremo. Fshehtësia që ajo kërkon-

te për këngën dhe performancën në skenë çuan në shumë hamendësime. Oksa nuk pranoi të publikojë tekstin e këngës edhe provat në skenë i bëri me dyer të mbyllura.

### Albumi

Albumi për të cilin Ana foli pak kohë më parë kur ishte në Shqipëri dali të premtën në tregun muzikor italian. Sipas ANSA-s, agjencisë italiane të lajmeve, albumi titullohet "La musica e' niente se tu non hai vissuto" (Muzika nuk është asgjë në qoftë se nuk ke jetuar) dhe do të nxirret nga shtëpia diskografike "Qazim Music/Emi Music". Përveç këngës "Gjyq vetvetes" konkurrese në Sanremo përmban edhe një këngë tjetër të papublikuar më parë. 7 këngët e tjera janë përzgjedhur nga repertori i saj dhe janë përpunuar muzikalisht. Madje janë

STAFI I GAZETËS  
ISO-POLIFONIA

"Iso polifonia-Albanian Folk Iso Polyphony"

"Kryevepër e trashëgimisë gojore të njerëzimit"

"A Masterpiece of oral and intangible heritage of humanity"

Organ i përmuajshëm i Këshillit të Muzikës Shqiptare, anëtar i Këshillit Ndërkombëtar të Muzikës IMC/UNESCO dhe seksionit Shqiptar të CIOFF-it. Gazeta botohet në qytetin muze të Gjirokastrës, "Pasuri kulturore e njerëzimit" mbrojtur nga UNESCO.

## KËSHILLI BOTUES

KRYETAR NDERI: Prof. Ramadan Sokoll  
KRYETAR I KËSHILLIT BOTUES:

Prof. Dr. Vasil S. TOLE.

## ANTARË:

Akademik Jorgo Bulo, Prof. Dr. Fatmir Hysli,  
Prof. Agron Xhagolli, Prof. Spiro Shituni (USA),  
Dr. Eno Koço (Angli), Prof. As. Josif Minga,  
Bardhyl Londo, Aleks Todhe.

DREJTOR: Niko Mihail.

KRYEREDAKTOR: Engjëll Serjani.

## KOLEGJIUMI I REDAKSISË:

Arian Avrazi, Ilir Dhuri, Lefter Cipa, Muhamet Tartari, Sejmen Gjokoll, Maks Kulo, Thanas Dino, Shkëlqim Hajno, Shkëlqim Guçe.  
Pregatiti materialet në anglisht: Gentiana Brahimi.

Art-Design: Klidi Proko.

Kontakt: Këshilli i Muzikës Shqiptare

e-mail: [tole@isopolifonia.com](mailto:tole@isopolifonia.com)

Mob: 0 68 21 55551

Seksioni shqiptar i Cioff-it:

E-mail: [egjikassoc@albmail.com](mailto:egjikassoc@albmail.com)

Cel: 0 69 22 34986

Gazeta "Iso polifonia-Albanian Folk Iso Polyphony":

E-mail: [ditajug@yahoo.com](mailto:ditajug@yahoo.com)

Cel: 068 22 04502



Këshilli i Muzikës Shqiptare-KMSH është person juridik i regjistruar pranë Gjykatës së rrethit Tiranë me nr. Akti 3074, me vendimin nr. 1784. K.M.SH-Albanian Music Council zyrtarisht njihet si Komiteti Nacional i Këshillit Ndërkombëtar të Muzikës (IMC)-UNESCO, në Shqipëri. (CIM/49.631).

Një jetë me studimin e iso-polifonisë  
Kontributi dhe vlerat e Prof. Benjamin Krutës në fushën e Iso Polifonisë

Nga Prof. Dr. Vasil S. TOLE



Është e pamundur që të flasësh sot për vlerat e iso-polifonisë pa përmendur emrin dhe kontributin e jashtëzakonshëm në studimin e saj të Prof. Benjamin Krutës, Prof. Ramadan Sokoli, dhe Dr. Spiro Shituni. Ata janë tre personalitet më të rëndësishme të studimit të iso-polifonisë nga çlirimi i vendit deri në vitet 1990. Prof. Benjamin Kruta ka lindur në Vlorë në 1940 dhe është ndarë nga jetë Tiranë në Tiranë në 1994. Të ndalesh në kontributin e tij nuk është e lehtë.

Në vitet 1959-1961 ai kryen studimet pranë konservatorit "Ciprian Porumbescu" në Bukuresht, studime të cilat i përfundon në Tiranë më 1965 në degën e muzikologjisë, me punimin me temë "Polifonia e Myzeqesë". Prej këtej fillon punë si punonjës shkencor pranë Institutit të Kulturës Popullore në Tiranë. Më 1970 caktohet si përgjegjës i sektorit të muzikës dhe ko-reografisë dhe më 1993 emërohet drejtor i këtij instituti. Më 1983 fiton gradën e "Kandidatit të shkencave" dhe më 1985 fiton titullin e "Bashkëpunëtorit të vjetër shkencor". Pas vdekjes i jepet titulli i "Drejtesit të kërkimeve". Në vitet 1971-1982 drejton si pedagog titullar lëndën e folklorit muzikor në Institutin e Lartë të Arteve. Ishte antar i Këshillit shkencor të IKP dhe antar i Këshillit Ndërkombëtar për studimin dhe katalogizimin e muzikës popullore me qendër në Bratislavë. Ka marrë pjesë pothuajse në të gjitha ekspeditat e kryera në të gjithë Shqipërinë si dhe në arbëreshët e Italisë dhe në Kosovë.

Ka regjistruar rreth 5 000 njësi folklorike për arkivin e Institutit të Kulturës Popullore, pranë Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë.

Tani që iso-polifonia është shpallur "Kryevepër e trashëgimisë gojore të njerëzimit", me respekt kujtojmë emrin e madh të Benjamin Krutës, i cili punoi një jetë të tërë për lartësimin dhe studimin e trashëgimisë kulturore shpirtërore shqiptare, në mënyrë të veçantë të iso-polifonisë. Vepra e tij studimore kushtuar iso-polifonisë është pjesë e trashëgimisë studimore shqiptare dhe si e tillë do të zërë vendin e merituar edhe në faqet e gazetës sonë kushtuar "Iso Polifon-

## Monografi: "Polifonia dy zërëshe e Shqipërisë së Jugut", Tiranë 1989

Artikujt shkencorë: "Polifonia e burrave të Myzeqesë", "Studime filologjike", 3/1968; "Polifonia e Skraparit dhe tipologjia e saj", "Studime filologjike", 4/1973; "Culadyjare, fyelli i dyfishtë shqiptar dhe disa paralele ballkanike", "Studime filologjike", 1/1975; "Vështrim i përgjithshëm i polifonisë shqiptare dhe disa çështje të gjenezës së saj",

"Kultura Popullore", 1/1980; "Polifonia dy zërëshe e Toskërisë", "Kultura Popullore", 1/1983; "Vështrim tipologjik i polifonisë labe", "Kultura Popullore", 1/1988; "Vendi i polifonisë shqiptare në polifoninë ballkanike", "Kultura Popullore", 1/1990; "Burdoni-isua në polifoninë shqiptare dhe disa çështje të gjenezës", "Kultura Popullore", 1/1991 etj.

ise". I paharruar qofsh Prof. Kruta!

Transkriptimet dhe botimet e ndryshme me shembuj muzikorë (me bashëkau-

torë) si: "Këngë popullore historike"-Tiranë 1968; "Melodi e valle popullore instrumentale" Tiranë 1969; "Këngë nga folklori i ri"-Ti-

ranë 1974; "Këngë popullore polifonike"-Tiranë 1984, përveç dhjetra artikujve popullarizues mbi folklorin në shtypin periodik shqiptar etj.

## Isopolifonia surpriza shqiptare e Sanremos

vijon nga faqja 1

dhënë detaje edhe për prezantimin e këtij albumi. Fotoja e kopertinës paraqet një Anna Oxa mjaft misterioze. Pas fytyrës së saj është një sfond tërësisht i bardhë, i dizenuar me pak të zezë. Sytë i ka të mbyllur, ndërsa flokët që i ka të hedhur pas janë të errët të ndarë me vijën në mes. Truku është i fortë, buzët me një të rozë të ndezur.

## Anna Oxa, humbet Sanremon rifiton vëmendjen

Debatet dhe xhelozitë kanë përfunduar. Anna Oxa dhe "gjqyqi shqiptar" janë mbyllur në natën e dytë të Sanremos. Këngëtarja ka qenë e para e skualifikuar nga kategoria e këngëtarëve "big" në konkurrim. Ka hapur natën e dytë të festivalit për të mbyllur konkurrimin e saj. Oxa e ka ndërruar veshjen në



të zezë, ndërsa grupi i këngëtarëve shqiptarë ishte veshur me fustanellat e jugut, qeleshet dhe opingat me xhufka. Pas polemikave për këngën e saj, i është dashur që të respektojë gjatësinë e lejuar. Kjo solli edhe një ndryshim të dukshëm në këngë. E megjithatë sjelljet e saj dhe mënyra se si është paraqitur në skenë janë komentuar gjatë në mediat italiane. Vëzhgimet kanë qenë të hollësishme për këngën, performancën e saj në skenë, idenë për të ruajtur gjithçka të fshehtë,

lukun e imtësi të tjera. Madje duke u kthyer edhe në "debate" artistike midis këngëtarëve. Të gjithë i kanë mëshuar mistikes në këtë konkurrim të trembëdhjetë të saj në edicionin e 56-të Sanremos. Por edhe pse e veçantë, me sa duket ideja që ajo kishte zgjedhur nuk është kuptuar. Vendimi i jurive për ta renditur të fundit në natën dhe skualifikuar në të dytën është pritur në mënyrë të ndryshme. Çështja "Oxa" ka ngelur paksa e mistershme, ashtu siç edhe nisi.

# Hymn për Ison



*Kryeveprat dhe krye-artistët, në përvijimin e portretit të popullit tim, që i krijoi ato*

Nga Timo Mërkuri

Kur më 25 nëntor 2005 Iso-Polifonia kaloi nën mbrojtjen e UNESCO-s si një nga pasuritë e rrala të trashëgimisë kulturore botërore, pakush e vlerësoi këtë si një sukses të ri dhe ca më pak të tjerë u ndërgjegjësuan për punën e madhe që është bërë për t'ia aritur kësaj dite.

Iso Polifonia ishte dhe mbetet kryevepër, këtë më së miri e dimë ne shqiptarët që e kultivojmë atë, por sukcesi është që të tillë arrin ta njohë dhe bota e qytetëruar dhe ca më tepër e merr në mbrojtje nga dëmtimi, që në këtë rast është harresa. Është normale që kur dikush të bëjë portretin tonë moral, përkrah dobësive që paraqiten do të vëjë edhe Butrintin, Gjirokastrën, Beratin e Iso Polifoninë. Kjo do të thotë që në një sipërfaqje më pak se 10 mijë metër katrorë, Shqipëria i jep njerëzimit jo pak, por katër kryevepra që shpallen pasuri botërore.

Nuk gjej dot një shembull tjetër identik në gjeografinë e botës. Dhe kjo mungesë ndër të tjerat na jep të drejtën e një krenarie të ligjshme. Duke menduar se të gjitha këto nuk kanë lindur nga hiçi dhe duke ditur se kryeveprat i bëjnë vetëm krye-artistët, atëherë plotësohet portreti i popullit tim, i bukur e me kulturë. Atëherë dikush do të rishikojë mendimet e veta për këtë portret.

Por ka edhe më në këtë akt vlerësimi e marje nën mbrojtje. Modernizmi i jetës, krijimi i qendrave të mëdha urbane, braktisja e fshatit dhe për pasojë largimi nga tradita, bën që të harrohet e të braktiset, të prishet struktura mbartëse e iso-s. a nuk e kini vënë re se shumë nga ne, ndonëse me origjinë labe nuk dinë të mbajnë iso. Ndërkohë që aplikojnë e zhvillojnë lloj-lloj shkollash e teknikash muzikore moderne. Nëpër shkollat tona, të rinjtë kanë një ndjenjë turpi dhe ndroje të lëngojnë labçe se mos shokët i quajnë të prapambetur, të dalë jashtë mode, etj, etj epitete që vetëm largojnë dëshirën për të kënduar labçe e për të mbajtur iso.

Pikërisht kësaj braktisje kësaj harrese i thotë ndal. Vendimi i UNESK-s i marë në 25 nëntor 2005, duke evidentuar vlerën e përsëritshme të saj, duke treguar modernitetin e ios-s. është njësoj si të marrësh në mbrojtje dhe t'i ruash nga prishja shtëpitë karakteristike të Beratit e të Gjirokastrës. Është e thjeshtë që ato të prishen e në vend të tyre të ngrihen gradaçela, por bota gradaçela ka në çdo qoshe të saj, ndërsa Gjirokastrë, berat, Butrint e Iso kemi vetëm ne.

Ne që kemi ngritur këto kryevepra s'e kemi të vështirë të ngemë gradaçela në të tjera vende se kemi të vështirë të ngremë lloj-lloj shkollash e teknikash muzikore. Por këtu shtrohet problemi të ruajmë ato që kemi ngritur në shekuj dhe që si ka kush tjetër.



Pamje nga veprimtaria për promovimin e gazetës dhe krijimit të rrjetit "Iso Polifonia", Përmet 22.02.2006.

Foto "Dita JUG"

## E lindur me dhimbje nga dhimbja

Po ç'është në vetvete kjo iso me jetgjatësi gati të barabartë me atë të njerëzimit. Si çdo gjë e madhe dhe e madhërishtme dhe iso-ja ka lindur me dhimbje dhe nga dhimbja. Dhe dhimbja nuk m'i është ndarë as sot, bile i ka dhënë fytyrën e formën e saj.

Nuk është e çuditshme që iso-ja dhe kënga që shoqëron ajo, së largu dhe në sipërfaqje i ngjan një vajtimi kolektiv, të një grupi njerëzish, i ngjan një rënkimi kolektiv. Ndoshta këtu duhet kërkuar arsyeja pse faktikisht dhe sot disa vajtime të vajtorëve shndërohen shumë lehtë në këngë me iso dhe ca më tepër në këngë të përpunuara.

### "Gatitu" para Isos

Iso-ja është e madhërishtme, është e tërëfuqishme. Ajo nuk njih autoritet që të mund ta ndërpresë. Po nisi iso-ja, sado i madh dhe autoritar të jetë ai që vjen, është i detyruar të presë sa të mbarojë iso-ja, pavarësisht se ata që e kendojnë mund të jenë njerëz fare të thjeshtë. Në këtë kontekst ata janë këngëtarë, mbajtës të iso-s. Vetëm pasi mbaron iso-ja (jo gjithë kënga, por vetëm iso-ja), pra pasi qetësohen mbajtësit e saj, vetëm atëherë i bëhen të gjitha nderet e duhura mikut të porsardhur. Dhe këtu s'ka asnjë qejfmbetje apo keqkuptim. Të gjithë i nënshtrohen këtij rituali.

Një fjalë e urtë thotë se miku është i dërguar i Zotit në shtëpinë e shqiptarit. Duke qenë se miku është i detyruar të presë sa të mbarojë iso-ja (çuditërisht është i vetmi detyrim që ka miku në shtëpinë e shqiptarit) atëherë rezulton se iso-ja vetë është më e lartë se një i dërguar i Zotit, diçka që ka lidhje me vetë Zotin. Ndaj në vetvete është e shenjtë dhe tërsisht e respektueshme nga të pranishmit. Ndaj nuk njih dhe nuk i hap rrugë asnjë autoriteti tokësor. Sepse ajo vetë është tepër qiellore. Madjemund të themi se ajo është vetë qielli, ku fluturon shqiponja e këngës. Këngët mund të jenë të rrëm-

byera, të shpejta, të ngadalta, këngë trimërie me krisam armësh si vetëtima apo këngë dashurie me ëmëlsinë e luleve të porsaçelura, kënga vaji që kullojnë dhimbje apo këngë gazmore. Gjithafërë llojesh mund të jenë këngët, por iso-ja është vetëm një, hijerëndë dhe madhështore si vetë qielli që mban shqiponjën dhe harabelin kështu këngët e përpunuara që gjithëses.

Ama duhet të pranojmë se jo kushdo mund të mbajë iso. Nuk është fjala t'ia bëjë në grup e e, por të krijojë një ambient komod për këngën përkatëse. Iso-ja nuk njih hierarki njerëzish, racash e feje. Mbajtësit e iso-s ulen gjithnjë bashkë, afrojnë kokat pranë njeri-tjetrit, bashkojnë zërat e tyre në një dhe kush i sheh nga larg s' mund të kuptojë krësesi sa veta janë e kush mban iso më mirë e kush më keq.

Për të mbajtur iso ulen pranë e pranë i pasuri e i varfëri, akademiku dhe analfabeti, bjondi e bruni, iriu dhe i vjetri, duke humbur kështu identitetet e tyre me të cilat dikur, diku mund të krenohen ose turpërohen, dhe duke u vënë tërësisht në shërbim të iso-s duke u shndëruar kështu në një atlas që mban mbi supë kupën e qiellit. Madje dhe hasmërit mund të ulen pranë e pranë, të mbanë ison dhe më pas diku larg mjedisëve të ios-s, detyrimisht larg këngës, të vazhdojnë

hasmërinë, të vriten me njeri tjetrin.

Por kurësesi në mes të iso-s, kurësesi pranë ios-s, askush nuk mund të guxojë të vëjë dorën në armë për të marrë hak apo për të vlarë. Arma shkrepet në prani të iso-s vetëm në drejtim të qiellit për të shprehur dhe rritur gëzimin e momentit. E pra vetëm iso-ja e ka çar-matosur shqiptarin. Në ndryshim nga kënga "majekrahi" e cila është shumë më e re se vetë iso-ja, kjo e fundit nuk mbehet kresesi nga një njeri i vetëm. Edhe kur dikush këndon një këngë me iso më vete dhe për vetë, përpiqet t'i japë asaj intonacionet e një grupi. Flamuri i iso-s është më i madhërisht se flamurkat e vockëla të partive politike të vetquajtuara të mëdha. Ka tremijë e më shumë vjet që valëvitet ky flamur. Ka parë njerëz, grupime njerëzish, parti e shoqata në zenith të tyre e në theqafje, por ai ka vijuar të qëndrojë aty, të presë e të përcjellë gjithfarësoj marëzish të mendjes njerëzore.

### Po si ka lindur vallë ky proces?

Njerëzimi para se të fillojë të këndojë, bile paa se të fillojë e të flasë ka filluar të qajë, të vajtojë, të rënkojë. Një dhimbjefizike ka provokuar lotë e rënkime, një dhimbje shpirtërore i ka bërë ato më të shpeshta, më ritmike. Njeriu pasi qan, vijon të rënkojë

për dhimbjen që provoi. Pikërisht ky rënkim është zanafilla e iso-s ndër-sa përkundrazi vajtimi është zanafilla e vargut të këngës.

Dhimbja shpirtërore për të dashurit e vdekur, shoqëruar kjo me ritin e varrimit, grumbulloi të afërmit praën të vdekurit. Dhimbja e shprehur me vajtim e rënkim herë të gjithëbashkë e here veç e veç, por gjithësesi vajtimi i njerit shoqërohej me rënkimet e të tjerëve, është zanafilla e grupit.

Dikur, dikush, kalimtar i rastit, apo pjestar i fisit që e4 pa këtë ritual dhe i dëgjoji vajtimet e rënkimet, mendoi se kjo ishte e bukur të përsëritej a për dhimbjen që provokonte, a për kujtimin e të dashurit të vdekur, a për vetë ëmbëlsinë që krijonte, qoftë kjo e dhimbjes. Dhe filloi ndoshta të përsëriste fjalët e vajtimin, apo të imitonte rënkimin, duke u bërë pa vet-dijen e tij në këtë mënyrë këngëtarë dhe mbajtësi i parë i iso-s. madje dhe emit fillestar i saj ka qenë me gjermën "y" dhe quhej Yso.

Dhe duke qenë se mbahej nga shumë persona u quajt yso e shumë vetave, në kuptimin "rënkimi kolektiv". Pastaj koha i hoqi gjermën "y", për të ardhur në shprehje iso. Por edhe popujt e tjerë kanë qarë e rënkuar, pse se kanë ata iso-n, mund të pyesë dikush. Po, kanë qarë dhe rënkuar dhe popujt e tjerë, por, merita e popullit tonë është pikërisht këtu, që këtë vajtim dhe rënkim e ngriti në art. Koret antike ilire, por edhe greke, nuk kanë qenë gjë tjetër veçse rënkimet dhe rënkueset pas dhe në mes të vajtimin, por këtë herë të ngritur në art.

Ka tremijë vjet ky rënkim, kjo merimangë kolektive që u përpuna duke aritur sot në majat e artit. Hoqi dorë e mori diçkaduke u përsosur vazhdimisht dhe u ngjit në piedestal. Na është renqethur trupi e shpirti, na ka gufuar zemra nga këngët e iso-t e tyre. Kemi vrapuar nëpër festa e festivale, kemi kënduar e debatuar me njeri tjetrin për më të bukurën e këngëve dhe të iso-ve, kemi hequr e hedhur vallen e rëndë të burrave të shoqëruar me këngë e iso, duke bërë të dridhet dheu nën hapat tona. Kemi jetuar me iso-n duke e bërë pjesë të domosdoshme e organike të jetës sonë. Dhe sot moderniteti i jetës, urbanizmi e progresi po kërcënojnë me harresë.

E pranoj që të hysh në detin e iso-s është si të jesh në mes të oqeanit, ku s'ke ku të shohësh brigje gjëkund. Po mos u trembni. Është i bukur ky det dhe të mban gjithnjë në sipërfaqje.

\*Folklorist

# Neço Muko legjenda e këngës himariote

*Disa fjalë për Neço Mukon, këngën dhe mikun e tij Janko Palin si dhe nënën time, Teftën*

Nga Dr. As. Prof.  
Eno Koço \*

vijon nga numri  
i kaluar

Shkrimi i kësaj *Parathënie* m'u porositi nga Petraq Pali, djali i Janko Palit, i cili më krijoi privilegjin të kujtoj këtu jo vetëm takimet e paharuaruara me t'atin e tij, por të përfshij edhe ndonjë kujtim tjetër siç janë bisedat me dëshmitarin e gjallë të viteve 1929-30, Pano Kokëveshin, ku tema kryesore do të ishte Tefta, nëna ime, e cila jetoi ndoshta çastet nga më interesantet e jetës së saj si pjesëtare e regjistrimeve me grupin himarjot të udhëhequr nga Neçja.

Në librin "Tefta Tashko-Koço dhe koha e saj," (Dituria 2000), kam përshkruar copëza jete të Teftës dhe grupit himarjot të N. Mukës në Paris, të treguara këto pikërisht nga anëtari e këtij grupi, *hedhësi* i këngës - Pano Kokëveshi. Të më falë lexuesi që në këtë *Parathënie* po hap një parantezë për Teftën, por ja që historia e regjistrimeve himarjote te viteve 1929-30 është e lidhur edhe me emrin e Teftës.

Është shkruar shpesh që një nga momentet më të shënuar në jetën e Teftës ka qenë kur ajo ishte ende 19-20 vjeçe dhe ftohet në Paris më 1930 nga Neço Muko e grupi polifonik himarjot, për të regjistruar me pjesëtarë të këtij grupi këngë solo apo duete të muzikës së lehtë, shqiptare dhe të huaj.

Duke qenë që kjo ngjarje e këto incizime i përkasin kohe më parë (viteve 1929-30) ka pasur edhe plot hamendje e historira lidhur me këtë eveniment. Pano Kokëveshi që ishte një nga këngëtarët e grupit e takova disa herë në Himarë dhe kjo që vijon është një nga bisedat me të ku mbajta dhe shënime:

"Më 1930 shkua nga Himara në Paris një grup më i madh; Neçoja, Koço Çakalli, unë, Andrea Bala, ndërsa Mitro Rumbo nga Përmeti nuk erdhi këtë radhë. Se ku i



NË FOTO:

Dr. As. Prof. Eno Koço dhe Vasil Tole, gjatë një ekspozite në ditët e festivalit "Përmetit Multikulturor 2004". Foto "Dita JUG"

kishte marrë adresat Neçoja nuk e di, por di me siguri që më 1930 i bëri letër Llambi Turtullit në Milano dhe Tefta Tashkos në Montpellier të bashkoheshin me ne në Paris më 1930. Veç këtyre u bashkua edhe Kleo Jorga, edhe kjo me banim në Paris. Kur mori vesh për mbërritjen tonë, Tefta u nis menjëherë nga Montpellier, vetëm, që të na takonte në Paris.

E ëma dhe veçanërisht Lekoja (i vëllai) u treguan të gatshëm ti jepnin leje duke i thënë: - Pa tjetër të shkosh e të punosh me muzikantë të ardhur nga Shqipëria. Tefta u paraqiti në zyrën e firmës *Pathé* dhe pasi pyeti në se kishin ardhur disa shqiptarë për të regjistruar këngë, i thanë që ishin poshtë në sallat e regjistrimit dhe e lejuan të takohej me ne. Mbaj mend se si u shpreh ajo: "Sa e lumtur jam që do të këndoje me patriotët e mi shqiptarë"

*Monografia mbi Neço Mukon, e cila po gjen dritën e botimit vetëm tani në dekadën e parë të shekullit XXI, do t'i tregojë shqiptarëve se nga ç'burim e kanë origjinën shumë shkrime mbi jetën dhe veprimtarinë Neço (H)Marriotit.*

[Këto si pas Panos ishin fjalët *mot à mot* të Teftës].

Neçoja, që si duket e njohu sipas fotografisë që kishte, e përqafoi. U përqafoam të gjithë si motra me vëllanë. Grupi qëndroi dhjetë ditë në Paris dhe Tefta erdhi katër ditët e fundit. Në fillim regjistruam këngët tona pa shoqërim, pastaj ato me të tjerë këngëtarë dhe me shoqërim. Të nesërmen bëmë një darkë."

Pas pyetjes time në se Tefta ka qenë në Sarandë për varrimin e Neço Mukos më 1934, Panoja mu përgjigj: "Nuk kishite se si të ishte në

varrimin e Neços sepse në atë kohë ajo ndodhej në Paris me studime. Dy tri herë më ka pyetur Hysen Filja në se kishte rënë gjë në dashuri Tefta me Neçon dhe unë i thashë që si ishte e mundur të ndodhte një gjë e tillë kur gjithsej qëndruam vetëm katër ditë bashkë dhe mbasi incizonim tërë ditën, në mbremje përsëri dilnim bashkë e shëtitim, bile një herë erdhi me ne dhe Kleo Jorga." (Bisedë në Klubin e Himarës, me nga dy gota fërnet dhe limonadë secili; 7 gusht 1982).

\* \* \*

Janko Pali në kuj-

timet mbi Neçon nuk bazohet thjesht mbi kujtesën e tij, mbi ngjarje që kishin ndodhur kaq kohë më parë të cilat me kalimin e kohës edhe mund të zbeheshin apo të humbnin vërtetësinë. Të qenit e një njeriu me kulturë të vyer, J. Pali jo vetëm konsultohet me materiale të shkruara të Neços të cilat ai kishte privilegjin t'i posedonte, por bazohet edhe në shënime/ditar e tija që kishte mbajtur me dekada të tëra. Veçanërisht me vlerë janë përkthimet në shqip të poezive të Neços të bëra këtu nga J. Pali nga gjuhë të ndryshme, kryesisht greqisht.

Ky bagazh i akumuluar ndër vite e bënte J. Palin të ishte i matur në gjykime e vlerësime duke luajtur kështu rolin e një kronisti autentik, të kthjellët e pa pasione. Sigurisht, duke pasur parasysh kohën kur i hodhi përfundimisht në letër kujtimet mbi Neçon

(1976), në to ekziston edhe një fill përshkues i "prudencës" ideologjike apo i kujdesit "profilaktik" (Lenini, "sulltani matjan") që "për çdo rast" punimi të ishte "korrekt" e në përputhje me kërkesat e kohës. Nuk ishin të paktë shkrimtarët e periudhës së pasluftës që mbruheshin me këtë lloj vetëkontrolli apo vet-censurimi.

Edhe pse afro gjysmë shekulli që nga vdekja e Neços, Janko Pali rrëfente për të sikur ngjarjet të kishin ndodhur vetëm pak kohë më parë. Monografia mbi N. Mukon (1976), për bindjet e mija, është punimi më autentik e i vërtetë për ligjëruesin/këngëtar të Bregut. Me njohuritë që kam, kjo është e para monografi e shkruajtur për Neço Mukon, edhe pse të tjerë artikuj e libra u botuan për të pas kësaj, të ndikuara drejtpërdrejt apo tërthorazi nga ky punim, të shfrytëzuara me lejen apo pa lejen e J. Palit.

Të vjen keq që mjaft autorë shkrimesh, padyshim dashamirës të Himarës dhe Neços, nuk respektuan mundin dhe integritetin e një njeriu kaq fisnik si Janko Pali edhe pse Mësues i Merituar, dhe kjo vetëm e vetëm se ai jetonte diku i veçuar, majë malit e jo në kryeqytet, por ama i rrethuar me libra në gjuhë të ndryshme, radhorë, pllaka gramafoni e kujtime.

Ai jetonte në një botë krejt të vetën dhe vështronte botën tjetër përqaq, deri thellë në Himarë, me një buzëqeshje të hidhur, mbase përthithur nga teoria filozofike e të *tërhequrit në vetvete* (*rassegnazione*).

Monografia mbi Neço Mukon, e cila po gjen dritën e botimit vetëm tani në dekadën e parë të shekullit XXI, do t'i tregojë shqiptarëve se nga ç'burim e kanë origjinën shumë shkrime mbi jetën dhe veprimtarinë Neço (H)Marriotit.

\* Senior Teaching Fellow in the School of Music University of Leeds, Leeds LS2 9JT, UK

## Kurse për mësimin e valleve tradicionale nga valltari i talentuar dropullit Andon Tunj

Grupi i këngëve dhe valleve të traditës "Identiteti ynë kulturor tradicional", fillon së afërmi kurse për mësimin e valleve tona tradicionale. Qëllimi është që duke u mbështetur në përvojën shumëvjeçare të kurseve të njëjta në Greqi të arrijmë ruajtjen dhe përcielljen në brezat e rinj të trashëgimisë tonë kulturore, mësimin e valleve tona tradicionale dhe të krahnave të tjera të Greqisë dhe prezantimin e tyre në veprimtaritë folklorike lokale, kombëtare e ndërkombëtare.

**Mënyra e organizimit:** -Kursët fillojnë nga mesi i muajit prill. -Ato do të zhvillohen në qytetin e Gjirokastrës e në Dropull. -Mund të marrin pjesë fëmijë dhe të rritur të moshës nga 7-30



vjet. -Mësimi do të zhvillohet në grup-mosha. Fillimisht një herë në javë, nga një orë. -Çmimi për regjistrimin 500 lekë. Tarifa mujore 1 500 lekë. -Për më shumë informacion kontaktoni në tel: 003069446034 / 0692120446 / 0692799707

Nga Dr. Spiro J. Shetuni\*

Një popull i lashtë ka art të lashtë. Një popull numerikisht i vogël mund të ketë një art estetikisht të madh. Arti i madhërishtëm, qoftë ky popullor ose profesionist, nuk lind detyrimisht në një mjedis të gjerë etniko-socialo-gjeografik. Ndosht jo rrallë që, për art të madh, të shquhen mjedise të vogla. Faktorë të ndryshëm, artistikë e jashtë-artistikë, i shpesh shpesh mjedise të tilla, sikurse edhe vetë kombet, popujt e grupet e vogla etnike në tërësi drejt një kulture popullore me të vërtetë orgjinale, të pasur, të gjallësishtme. Muzika popullore shqiptare përfaqëson, si nga pikëpamja substanciale, ashtu edhe nga pikëpamja formale, një pasuri artistike me të vërtetë monumentale. Në përplekjet për një hulumtim sa më të plotë, vazhdimisht ngre krye çështja se ku qëndron, në radhë të parë, thelbi formal i saj.

Lajmi i datës 25 Nëntor, 2005, kur Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s, Koiuchiro Matsuura, proklamoi si një ndër Kryeveprat e Trashëgimisë Orale dhe të Paprekshme të Njerëzimit, midis të tjerash, edhe Muzikën Popullore Polifonike Shqiptare shpreh në mënyrë zyrtare vlerat origjinale, të shquara, të mëdha e të shumanshme të kësaj pjese të muzikës sonë popullore. Duke e vendosur në një radhë me kryevepra të tilla botërore, si: Ramllila: interpretimi tradicional i Ramayana-s (Indi), Teatri Kabuki (Japoni), Maskarada Makishi (Zambia), Samba e Roda-s (Brazil), etj., ky proklamim vjen si një vlerësim ndërkombëtar, i cili tërheq vëmendjen e opinionit shoqëror mbi vlerat e kësaj trashëgimie. Shpesh të lëna në mëshirën e fatit, pa dyshim se Kryeveprat e Trashëgimisë Orale dhe të Paprekshme të Njerëzimit janë një tregues thelbësor i identitetit nacional të kombeve, popujve e grupeve të ndryshme etnike.

Nëse muzika popullore monofonike shqiptare bën jetë kryesisht në Gegëri (dialekti muzikor geg dhe pjesërisht dialekti muzikor qytetar), muzika popullore polifonike shqiptare ekziston përgjithësisht në Toskëri (dialekti muzikor tosk, dialekti muzikor lab dhe pjesërisht dialektimuzikor qytetar). Muzika polifonike e dialektit tosk, muzika Polifonike e dialektit lab dhe ajo e dialektit qytetar përfaqësojnë së toku një ndër dëshmitë më të spikatura të talentit artistik të popullit shqiptar.

Krahas muzikës monofonike të dialektit geg dhe të dialektit qytetar, ajo (muzika polifonike toske, labe, qytetare) përbën një përmasë të rëndësishme brenda tërësisë së muzikës popullore shqiptare. Kultura muzikore polifonike shqiptare është shquar gjithmonë nga një gjallësi dhe densitet i madh. Si bashkëudhëtare e ditëve të gëzuara e të trishtuara të popullit shqiptar, ajo ka simbolizuar vazhdimisht një art të dashur për të. Duke pasqyruar aspekte të ndryshme të historisë dhe jetës së popullit, muzika tradicionale polifonike ka luajtur një rol të rëndësishëm edukues: shoqëroro-atdhetar dhe artistiko-estetik. Në këtë mes, pa dyshim që ndikim të veçantë ushtronte dhe mënyra kolektive e interpretimit të saj. Për mbarë



Në foto: Spiro Shetuni Agron Xhagoll dhe Vasil S. Tole.

# Një popull i vogël mund të ketë një art të madh

*Muzika popullore shqiptare përfaqëson, një pasuri artistike të vërtetë monumentale*

opinionin shoqëror, muzika popullore polifonike nuk përfaqëson vetëm një monument kulturor të së kaluarës, por, në të njëjtën kohë, edhe një dukuri bashkëkohore me ndikim të fuqishëm mbi artdashësit.

Muzika popullore polifonike shqiptare ekziston në katër grupime kryesore të kënduarit ose të interpretuarit, të cilat emërtohen sipas krahnave përkatëse etnografike të Shqipërisë së Jugut: Toskëri, Myzeqe, Çamëri, Labëri. Mirëpo, duke u nisur nga një varg faktorësh lëndor-substancialë e strukturor-formalë, grupimet kryesore të të kënduarit ose të interpretuarit të saj, në thelb, formojnë vetëm dy dialekte muzikore kryesore: dialektin muzikor tosk (i cili ekziston në tre nën-dialekte muzikore: nën-dialekti tosk, nën-dialekti myzeqar, nën-dialekti çam, së toku dhe dialektin muzikor lab. Vëmë në dukje se muzika popullore polifonike shqiptare, nga pikëpamja e strukturës së përgjithshme, ekziston në tre lloje ose grupe kryesore: muzikë polifonike me dy linja melodike ose dy-zërëshe, muzikë polifonike me tri linja melodike ose tri-zërëshe, muzikë polifonike me katër linja melodike ose katër-zërëshe. Ndër to, muzika polifonike dy-zërëshe përdoret vetëm në disa fshatra ose zona të caktuara të Toskërisë, Myzeqesë, Çamërisë e Labërisë; muzika polifonike tri-zërëshe gjallon veprueshmëri në të katër krahinat e mëdha etnografike të Shqipërisë së Jugut; kurse muzika polifonike katër-zërëshe përdoret vetëm në krahinën e Labërisë.

Më shpesh, solisti i parë i muzikës popullore polifonike shqiptare quhet marrës, i dyti - prerës ose kthyes, i treti - hedhës ose mbushës dhe përbërësi i katërti - iso. Ky i fundit, në dallim nga të tjerët, këndohet ose interpretohet prej shumë vetëve. Emërtimi i solistëve (këngëtarë ose instrumentistë) shpreh një raport të përcaktuar mirë, ai nisur nga një lidhje përmbajtjeje, e brendshme dhe organike, që ekziston midis tyre. Duke folur në vija të përgjithshme, mund

të pranojmë se marrësi, solisti i parë, e drejton muzikën polifonike nga çdo pikëpamje; prerësi ose kthyesi, solisti i dytë, ose luan një rol imitues, ose e përthyen atë në të gjitha drejtimet; mbushësi ose hedhësi, solisti i tretë, e pasuron muzikën polifonike sidomos nga pikëpamja harmonike; ndërsa isua, përbërësi i katërt, e bën atë të qëndrueshme veçanërisht nga pikëpamja tonale, etj. Në këtë mënyrë, emrat marrës, prerës ose kthyes, hedhës ose mbushës, iso parakuptojnë role të ndryshme, kontradiktë e unitet midis tyre, dhe, në fund të fundit, parakuptojnë njëri-tjetrin.

Isua, i cili përfaqëson një tingull të vazhdueshëm, tingull që është qendra modo-tonale ose qendra e gravitetit të pjesëve muzikore, në varësi të mënyrës së përfimit, nëse ajo përftohet me anë të zërit njerëzor, apo me anë të instrumenteve muzikore, mund të ndahet në dy kategori kryesore: zanore e instrumentore. Duke qenë një element i pazvëndësueshëm i muzikës popullore polifonike shqiptare, isua zanore haset dhe në kultura muzikore të kombeve, popujve e grupeve të tjera etnike të botës. Krahas muzikës popullore polifonike të disa popujve ballkanikë, kujtojmë, gjithashtu, muzikën popullore polifonike të Gjeorgjisë, stilin muzikor polifonik të ashtuquajtur "të kënduarit me grykë" të Mongolisë, muzikën tradicionale polifonike indiane, etj. Notat që përdoren për ison në muzikën tradicionale indiane janë dy: qendra tonale dhe kuinta e pastër mbi të (do-sol).

Ndërkohë, edhe isua instrumentore është e pranishme në mjaft kultura muzikore kombesh, popujsh e grupesh etnike. Ndër instrumentet muzikore tradicionale që përftojnë iso, vëmë në dukje vegla, si: gajde (instrument aerofon, i cili konsiston nga një tub me gjuhëz, tub që futet brenda një rezervuari lëkure); banjo (instrument kordofon, emri i të cilit ndoshta vjen nga fjala portugeze ose spanjolle bandore); fidell (term i përdorur për çdo instrument kordofon që luhet me hark); dulcimer

(emër i përdorur për instrumente të caktuara të tipit të zithrës me më shumë se një tel, por pa tastjerë); tambura ose tanpura (një lloj luti me qafë të gjatë i përdorur në Indi), etj.

Sidoqoftë, isua, zanore ose instrumentore, duke mos qenë një dukuri e izoluar të themi thjesht ballkanike, përsëri përdoret në mënyrë të veçantë, pra, sipas kulturave muzikore të kombeve, popujve e grupeve të ndryshme etnike.

Çështja e origjinës, kohëlidjes, moshës së muzikës popullore polifonike shqiptare, në kushtet e mungesës së plotë të dokumenteve historike, sidomos të pjesëve muzikore zanore e instrumentore të notizuara, paraqitet mjaft e ndërlikuar. Në këtë mënyrë, kryesisht për shkak të faktoreve objektive, deri më sot, ajo s'ka gjetur ende një zgjidhje të plotë e përfundimtare. Studiuesit etnomuzikologë shqiptarë interesohen rreth saj jo si për një kuriozitet të thjeshtë, por, me të drejtë, si për një çështje me rëndësi të veçantë. Është kup-timplotë që gjithashtu mjaft studiues të huaj, si, p.sh. Hornbostel, Lahman, Shnajder, Tardo, Saks, Rihtman, Kotonksi, Sabieski, Shtokman [Doris], Stoin, Kacarova-Kukudova, Kaufman, Jashçenko, Viora, Kollaer, Elshek, Emshajmer, Elshekova, etj., sipas rasis, në një masë më të vogël ose më të madhe, në një mënyrë të tërthortë ose të drejtpërdrejtë, i janë drejtuar, herë-herë, qoftë fillesës së muzikës tradicionale polifonike në përgjithësi, qoftë asaj të muzikës tradicionale polifonike të vendeve përkatëse në veçanti (Elschekova 1981, Hornbostel 1914, Kaufman, 1967, Lahmann 1929, Rihtman 1951, Sachs 1962, Schneider 1934-35, Stockmann [Doris] 1964, Tardo 1938).

Përgjithësisht, krahas përplekjeve për të zbuluar tiparet themelore dalluese të muzikës popullore polifonike, ndër çështjet që janë bërë objekt studimi, në raste të tilla, kanë qenë: a) hapësira brenda së cilës gjallon muzika popullore polifonike; b) koha e lindjes së muzikës popullore polifonike; c) marrdhëniet mi-

dis muzikës popullore polifonike dhe muzikës kishtarë bizantine.

Studiuesit janë të mendimit se muzika popullore polifonike e popujve të Ballkanit përfaqëson një kulturë muzikore tepër të hershme. Zanafilla e saj duhet t'i takojë epokës kur kultura e lashtë trako-ilire sundonte në tërë gadishullin. Por ajo s'ka bërë jetë vetëm nëpër fshatara, sikurse mendohet gabimisht ndonjëherë. Muzika popullore polifonike, siç dëshmojnë vetë tiparet më të përgjithshme dalluese që e karakterizojnë atë, simbolizon, në radhë të parë, një kulturë të lashtë, të vjetër, arkaike.

Ndoshta është me interes që të vihet në dukje se simpoziumi ndërkombëtar Polifonia e popujve të Ballkanit, i cili i zhvilloi punimet e tij në Tiranë (Shqipëri), nga data 6-7 tetor, 1989, vuri në epiqendër të tij pikërisht një çështje aq të rëndësishme për etnomuzikologjinë ballkanike: muzikën polifonike të popujve të Ballkanit. Është për të ardhur keq që materialet e këtij simpoziumi ende s'e kanë parë dritën e botimit!

Ndonëse me vonesë, botimi i tyre do të materializonte, në një farë mase, vëmendjen ndaj arritjeve më të mira shkencore të deri-sotme mbi hulumtimin e muzikës popullore polifonike shqiptare e ballkanike. Të kënduarit shumë-zërësh në Ballkan e në Mesdhe, u mbajt në Vjenë (Austri), nga data 11-13 mars 2005, do të botohen pa humbur shumë kohë.

Çështja e origjinës, kohëlidjes, moshës së muzikës popullore polifonike shqiptare, e cila pa dyshim që lidhet ngushtë me origjinën, kohëlidjen, moshën e muzikës popullore polifonike të kombeve, popujve e grupeve të tjera etnike të gadishullit të Ballkanit, është një çështje, sa tërheqëse, aq edhe e ndërlikuar shkencore. Duke studiuar, si dokumente të mundshme historike, ashtu edhe materialin e gjallë muzikor; duke iu drejtuar herë-herë historisë, herë-herë etnomuzikologjisë e herë-herë disiplinave albanologjike; duke i marrë këto disiplina gjithmonë të lidhura midis tyre; duke përthithur, si arritjet më të mira brenda vendit, ashtu edhe arritjet më të shquara ndërkombëtare, etj., dalëngadalë, ajo do të vijë përherë duke u ndriçuar. Nëse proklamimi i Muzikës Popullore Polifonike Shqiptare nga ana e UNESCO-s si një ndër Kryeveprat e Trashëgimisë Orale dhe të Paprekshme të Njerëzimit shpreh në mënyrë zyrtare vlerat origjinale, të shquara, të mëdha e të shumanshme të kësaj pjese të muzikës sonë popullore, opinionit të gjerë shoqëror dhe atij shkencor shqiptar i shtrohet si detyrë e përhershme mbrojtja e kësaj pasurie. Nga pikëpamja praktike, një proces i tillë nënkupton, ruajtjen e origjinalitetit, individualitetit, papërsëritshmërisë etniko-kombëtare kurse, nga pikëpamja teorike, ai parakupton studimin e thellë të origjinës, të mjeteve kryesore shprehëse, të stileve muzikore më përfaqësuese, të evolucionit historik, të afrive e dallimeve me dialekte të tjera muzikore.

\*University of Miami Coral Gables, FL, USA

# Profil i ansamblit polifonik "Zëri i Bilbilit"

*Interpretuesit originalë që përçojnë kudo polifoninë e zonës së Sarandës*

**G**rupi polifonik "Zëri i Bilbilit" është krijuar në dhjetor të 2000-ës, nga një grup apasionatësh pas këngës polifonike, si zoti Sinan Ahmeti, Trifon Golemi, Pelivan Basho, Xhelal Micka, Haxhi Aliko, Emin Bello, Agron Xhuvani, Përparim Bajrami dhe Persefoni Miho.

Ky grup që nga krijimi deri sot ka dhënë pesë koncerte recitale në qytetin e Sarandës, që të gjitha të suksesshme dhe të mirëprituar nga publiku. Pjestarët e grupit janë ftuar të marrin pjesë në shumë aktivitete që ka organizuar bashkia dhe qendra kulturore e qytetit të Sarandës, si vepërimitarë për hapjen e sezonit turistik, festat e Çlirimit, etj.

"Zëri i Bilbilit" ka qenë i pranishëm në shumë festivale të organizuara në Gjirokastrë, si dhe në festivalin e veglave muzikore. Në 6 vjet jetë anëtarët e grupit kanë patur një aktivitet të dendur pjesëmarrës, në festivalin "Iso Polifonia" në Vlorë, në festivalin "Multikulturor" në Përmet. Koncerte recitale janë prezantuar edhe në qytetin e Delvinës.

Përveç aktiviteteve kombëtare renditen pjesëmarrjet në aktivitete ndërkombëtare, si në Tuz të Malit të Zi, ku u vlerësuan me çmim për interpretim të mirë. Ndryshe nga herët e tjera këtu grupi u prezantua me një larmi numrash artistik, si një ansambël, me këngë polifonike, me këngë e valle popullore me orkestrinë, etj. Ftesat në drejtim të grupit kanë qenë të shumta në vende të ndryshme si Turqi, Greqi, por që nuk janë realizuar për arsye fondesh.

Ftesa më e fundit është ajo që vjen për këtë vit. Në muajin gusht prej datës 21 deri në 26 gusht jemi ftuar nga shteti bullgar për të marrë pjesë në një festival që organizohet aty. Të gjitha këto flasin për vlerat e këtij grupi që spikat për interpretimin origjinal dhe ruajtje të traditës së polifonisë së zonës.

Interpretimet në këtë grup shoqërohen në shumë raste edhe nga



Në foto: Grupi polifonik "Zëri i bilbilit".

instrumenta popullore si longari dhe cula. Përmasat e grupit sot janë tejkaluar, pasi ai është shndërruar në një ansambël ku elementët ar-

tistikë që ofron janë më të shumtë. Krijimi i ansamblit u shoqërua edhe me shoqatën kulturore me të njëjtin emër Asambli Kulturor "Zëri i

Bilbilit.

"Zëri i Bilbilit" ka nxjerrë në treg albumin e tij të parë dhe shumë shpejt dashamirësit do të kenë në treg edhe al-

Pjestarët e Grupit "Zëri i bilbilit"

- |                   |                     |
|-------------------|---------------------|
| 1. Sinan Ahmeti,  | 6. Emin Bello,      |
| 2. Trifon Golemi, | 7. Agron Xhuvani,   |
| 3. Pelivan Basho, | 8. Përparim Bajrami |
| 4. Xhelal Micka,  | 9. Persefoni Miho.  |
| 5. Haxhi Aliko,   |                     |

bumin e dytë. Disa prej këngëve më të spikatura që kanë mbetur në kujtesë të artëdashëve janë: Çelën lulet mbi Delvinë, Gunë e zezë e feste bardhë, Këngë për Idriz Ali Dhimen, Kumbullo sumbull e kuqe, Dërgomë vetullat e tua, Dilni shihni Shazeno, Pikë gjakut u kish hije, Do t'i këndoju Labërisë etj.

Realizimi i këngëve të grupit është bërë nga disa poetë të njohur si: Zaho Vasili, Fitim Çausi, Enver Isufi, Petrit Me-

tushi, Teno Lolaj. Interpretuesit e grupit janë: Arben Çuko, Trifon Golemi, Persefoni Miho, Emin Bello, Haxhi Aliko, Argjiro Bello, Agron Ymeri, Fatmir Hamzai, me drejtues të grupit Sinan Ahmeti.

Në fillimet e tij ka patur pjestarë të tjerë që për arsye të ndryshme, kryesisht pune janë larguar nga qyteti i Sarandës.

Sinan Ahmeti  
Drejtuesi i grupit polifonik "Zëri i Bilbilit"

## Magjia e Polifonisë



Nga  
Sejmen GJOKOLI

S'do të më shlyhet nga kujtesa ajo ç'ka do të përjetoja Gusht - Shtatorin e vitit 1994 në Hamburg të Gjermanisë. Si pjesëtar i grupit të famshëm të Vranishtit të Vlorës, së bashku me Muhamet Tartarin, rapso e drejtues i njohur i këtij grupi, do të provonim ndjesi dhe emocione të provuara më parë. Të gjitha, si pasojë e kontaktit që polifonia e trevës së Labërisë pati me dëgjues e shikues të botës europiane, gjatë turneut të zhvilluar në një nga vëndet metropol të botës.

I kisha ndjekur hap pas hapi vranishjotët për

këngën dhe vallen e rrallë. E kisha parë e dëgjuar Arap Çeloleskën në këngë e në valle; Sinan Gjolekën e Spiro Cinon gjithashtu. Pa harruar, Leskon, Leonorën e Azimenë. Po atje në Hamburg, m'u desh të përjetoja vërtet magjinë e këngës polifonike. Për here të parë, mijra kilometra larg vëndit tim, pata rastin të dëgjoja se si tingëlonte ky visar i folklorit shqiptar. Për herë të parë pashë nga afër, jo vetëm studjues e muzikologë folklori, por njerëz të thjeshtë që dëgjonin të magjepsur...

Falë mirësisë së tyre kam patur disa herë rastin të radhitem dhe vetë në gjerdanin e valles së rëndë të këtij fshati me emër e histori të madhe në Labëri. Gjithëmonë jam tronditur por asnjëherë kjo valle e rrallë s'më është dukur e s'më ka tingëlluar si në atë hollin e madh, me kollona gjigande, të muzeut të Hamburgut. Si vallja ashtu dhe kënga me iso. U dhashë të drejtë gjermanëve që na ndiqnin kudo të mahnitur...

Afro një vit më vonë, më 1995, do të provoja të tjera emocione të polifonisë shqiptare. Kësaj here në lindje të Europës,

në Moldavi. Miku i mirë, folkloristi i shquar, gjirokastri Agron Fico do të na krijonte mundësinë që me grupin folklorik "Bilbili" të Vlorës, të sapo krijuar me disa prej yjeve të polifonisë, të merrnim pjesë në një festival folklori.

I kam si sot në vëmendje shumë prej kontakteve që patëm me folkloristë e muzikologë të vendeve të ndryshme, gjatë ditëve të atij festivali. Dy prej tyre, studiues hungarezë folklori, ju qepën "këmba këmbës", si i thonë, treshes së famshme të Dukatit. Artistët e talentuar Leko Gjoleka, Bego Vangjeli dhe Sulo Bozhani, do të çuditnin dynjanë me mënyrën e tyre të të kënduarit. Tre

burra - një këngë. Marrje, kthyes, hedhje dhe iso Harmonizim zërash deri në përsosmëri.

Mbase mend se juria e festivalit diskutoi gjatë dhe jo pa debate për vlerësimet dhe ndarjen e çmimeve. Mes grupeve nga Moldavia, Rumania, Hungaria, Bullgaria, Franca, Turqia etj. "Bilbili" ynë u nderua me çmimin e parë për folklorin. Vetëm polifonia e bëri jurinë të "dorëzohet". Mbase rastësi, por kur më duhet të flas për jehonën e iso-polifonisë një tjetër ngjarje e madhe folklori më ngacmon kujtesën. Jo shumë larg. Vetëm një dekadë më parë "Bilbilat" e Vlorës përfshirë edhe disa "gjeneralë" të polifonisë do të gjëndeshin në të parin Festival Botëror të

Folklorit, bash aty në qytetin Brumsum të Hollandës. Edhe këtu autenticiteti i folklorit shqiptar do të bënte "beli". Avazet e këngës vranishjote e dukatase, por edhe ato të Lapardhasë e Pilurit me Nazifin, Golikun e Emrioni Merkurin na bënin të njeheshim vërtet krenar në atë "det"botëror folklori. Këtu e kam perjetuar vërtet, me të gjithë miqtë e mi pjesëmarrës në atë dasmë të stërmadhe folku, peshën dhe autoritetin e polifonisë së vëndit tim. Këtu Jean Roch, ky mik i madh i polifonisë shqiptare do të krenohej e gëzohej shumë që kish kontribuar drjt përdrejt që të ishte edhe iso-polifonia shqiptare në atë përballje gjigande folklori.



Në foto: Grupi polifonik i Vlorës "Bilbili".

# Çajupi, tradita dhe iso polifonia zagorite

## *Pasqyrimi i traditës popullore në veprat e poetit Andon Zako Çajupi*



Nga Ermir Nika

Vendlindja luan një rol të rëndësishëm në formimin psikologjik të një shkrimtari varësisht nga koha që ka kaluar në gjirin e saj, nga këndi që e ka kundruar pasurinë shpirtërore të popullit dhe nga rrethanat sociale, shoqërore, historike e poli-

tike të kohës. Por, për ta kristalizuar më tej këtë mendim, gjykojmë se është e nevojshme të vëzhgohet imtësisht lidhja e poetit me traditat popullore në përgjithësi, me jetën zakonet dhe mentalitetin e popullit të krahinës së Zagories. Vepra e Çajupit, me përmbajtje e frymë popullore mund të mishërohet veçse në stilin e këngës popullore. Shumë nga elementet e prozodisë popullore, vargjet trokaike të përziera si në modelin e poezisë popullore, por, natyrisht, në mënyrë shumë më mjeshërore, forma e ndërtimit të fabulave, ritmi i vargut, muzikaliteti që e përçon këtë poezi, shpjegon faktin se në poezinë e Çajupit ndihet filladi i këngëve të krahinës së Zagories. Me që Andon Çakua u largua nga fshati në moshë relativisht të pjekur dhe e vizitoi atë deri në moshën njëzet e një vjeçare, ai diti të marrë nga fshati dhe nga krahina atë që ishte më e dobishme për formimin e tij psikologjik e letrar. Lidhja me traditën popullore ishte kaq e fortë, sa u ruajt dhe la gjurmë të thella në personalitetin dhe jetën e poetit. Krahas këngëve dhe valleve, gjinia zotëruese e folklorit të Zagories mbetet lirika. Në lirikë muza e poetit u ushrye me gurrën e freskët të poezisë popullore të krahinës së vet. Në vjershat e tij erotike gjejmë po ato koncepte e norma morale që karakterizojnë jetën e vërtetë të popullit. Prandaj, veçanërisht për të vendlindja ka një kuptim të veçantë dhe s'mund të mendohet njeri pa tjetrin: Sheperi e Zagoria pa Andonin dhe Andoni pa Sheperin e Zagorinë.

Zagoria është një krahinë e madhe e rrethuar nga të katër anët me male të lartë që gjatë kohës mbajnë dëborën e dimrave të gjatë e të ashpër dhe me qytetet e tjera lidhet vetëm përmes tri portave natyrore: grykës së Selckës që e lidh atë me Lunxherinë dhe Gjirokastrën, grykës së Dhëmbelit që e lidh me Përmetin dhe grykës së Këlcyrës që e lidh me Tepelenën dhe Gjirokastrën. Kjo krahinë ka një florë dhe faunë të pasur. Veçmas do të dallonim malin e Çajupit pse për Andonin është "aq i këndshëm, i lulëzuar dhe i gjelbëruar në verë", megjithëse "në dimër nuk është veçse strofkë e bishave të egra" flet për një natyrë plot kontraste, plot variacione që gjatë së kaluarës, e ka bërë jetën e këtyre banorëve të mundimshme, të vështirë, por vetë ata të fortë, të qëndrueshëm, me plot dashuri e respekt, për atdheun e vendlindjen, me shpirt të pasur me emocione siç thotë një studiues "zagoritët janë këngëtarë, poetë nga shpirti".



Kurbeti ka qenë një plagë shoqërore që i ka preokupuar gjatë së kaluarës veçanërisht fshatrat e Zagorisë. Sipas një grafikoni të Muzeut të Sheperit, shihet se sheperiotët kanë filluar të emigrojnë që nga shekulli XVIII duke marrë së pari rrugën e Stambollit, kah fillimi i shekullit XIX atë të Sofjes dhe kah fundi i shekullit XX mori dy drejtime: për Bukuresht e për Misir, duke dominuar ai i Misirit. Kur niseshin kurbetçijët, gratë e pleqtë i shoqëronin larg fshatit dhe, kur ndaheshin, shkullnin pak bar dhe e vinin në shtratin ku kish fjetur kurbetçiu natën e fundit, me qëllim që ai të mos e haronte kurrë shtëpinë e tij e të kthehej shpejt. Motivet e këtij fenomeni shoqëror kanë qenë të shumta dhe në një mënyrë na i shpreh edhe Andon Çakua.

Çajupi që i muhabetit e i këngës labçe në çaste gëzimi e hidhërimi, këndonte bukur dhe ruante gjallë atë humorin e hollë fshatarak; zakonet e Zagorisë i pëlqenin dhe i pat respektuar ato edhe kur qe larg vendit. Edhe gjuha dialektale e përdorur prej Çajupit, është shprehje e lidhjes së tij me traditën popullore, e vlerësimit të lartë që ai personalisht i bëri gjuhës popullore. Ashtu si për rilindasit e tjerë, edhe për Çajupin gjuha është një element i fuqishëm, i domosdoshëm për ruajtjen e racës. Këto tipare, që gëlonin në gjuhën kombëtare, duhej të pohoheshin përmes veprave të ndryshme letrare të denja për kohën që jetonin. Duke ndjekur këtë rrugë, Çajupi solli një kontribut të çmueshëm për pasurimin e shqipes së shkruar me frazeologjinë e pasur popullore, me shprehje të freskëta dhe të gjalla. Edhe në këtë anë duhet të shohim lidhjen e tij me traditën popullore në përgjithësi. Duke pasur këtë lidhje të fortë shpirtërore me folklorin dhe për rrjedhojë edhe me realitetin shqiptar të asaj kohe, me hallet, brengat, dhe gëzimet e ndryshme, pra në këtë mënyrë edhe me artin dhe mendësinë e asaj shtrese popullore, Çajupi mori shpirt e para për një pasqyrim të drejtpërdrejtë të atij realiteti të egër e mbytës dhe në këtë mënyrë. Ai u

bë shkrimtari i parë që hodhi bazat e frymës kritike në letërsinë shqipe, duke pasqyruar me një origjinalitet të theksuar jetën ekzotike shqiptare, çka e dallon atë në krijimtarinë artistike nga të gjithë shkrimtarët e tjerë paraardhës apo bashkëkohës të tij. Nga të gjitha këto fakte dhe argumente arrijmë në përfundimin se lidhja e brendëshme dhe e kudo ndodhëshme e Çajupit me folklorin përbën në vetvete një fakt të pamohueshëm, se Andoni ka qenë i ndërgjegjshëm për këtë rrugë që ka ndjekur përgjatë gjithë krijimtarisë së tij shumëdimensionalëshe. Që arrijmë në konkluzionin se këtu nuk është fjala për huazimin e ndonjë vargu apo figuracioni të shkëputur diku nga krijimtaria popullore, por për një shkrimtar të frymës së tij letrare me shpirtin popullor, me ndjenjat, përfytyrimet baritore dhe botëkuptimin e asaj shtrese të thjeshtë shoqërisë shqiptare që jetonte me hallet, doket dhe zakonet tradicionale në atë skaj të veçarit të globit.

Kultura e një populli, rruga e të cilit ka kaluar nëpërmjet shumë momenteve të ndryshme historike, kanë spikatur personalitete të ndryshme në fushën e letrave, veprimtaria e të cilëve përmbledhet vetëm brenda një epoke të caktuar historike. Përgjithësisht me veprën e tyre në tërësi, ata bartin fizionominë morale dhe artistike të kësaj epoke. Ndërkohë ka edhe shkrimtarë të tjerë të cilëve u takon të jetojnë në kapërcyell të dy epokave. Por është pikërisht kjo dykohësi që përshkon veprën e tyre cila përbën në vetvete një rrezik të dukshëm pasi krijimtaria e tyre kërcënohet të mbetet e kufizuar vetëm në një kolonë brenda një sistemi artistik që tashmë e ka jetuar apogjeun e vet. Në këtë kontekst duhet thënë se këtë rrezik e kalojnë vetëm ato talente që me krijimtarinë e tyre përbëjnë sintezën më të lartë të prirjeve krijuese të epokës që po kalon dhe njëkohësisht ata bartin në vetvete prirjet e reja të asaj epoke historike dhe artistike që po agon. Dhe pa dyshim Andon Zako Çajupi është një ndër këto talente. Emri i tij spikati në letrat shqipe pas shkëlqimit të yllit poetik të Naim Frashërit dhe në vazhden e një kohë kur emra të tjerë dinjtozë poetësh do të shfaqeshin në hapësirën letrare të kohës. Nuk duhet lënë pa përmendur se ai nuk mbeti as hije e të parit dhe as një shkrimtar i tejkaluar për e brezin e ri. Në këtë mënyrë, duke e parë krijimtarinë e tij në dy kënde në atë sinkronik dhe atë diakronik, vërejmë se roli i tij i veçantë në etapat e zhvillimit dhe pasurimit të letërsisë shqiptare në fillimet e shekullit XX është i padiskutueshëm Lëvizja Kombëtare kërkonte një letërsi të re që t'u paraprinte kërkesave të saja më imediate, që t'u tregojë rrugën më të shpejtë e më të guximshme për sendërtimin e idealeve të pritura kaq gjatë. Si rezultat i nevojave dhe kërkesave më aktuale të kohës, lindi letërsia e fazës më të re të Rilindjes Kombëtare, letërsia e fillimit të shekullit XX e përfaqësuar me Çajupin dhe Andonin, e cila me të vërtetë u bë udhërrëfyes e Lëvizjes Kombëtare duke gërshetuar dy kërkesat më aktuale të kohës: lirinë politike dhe lirinë shoqërore.

## FJALOR I ISO-POLIFONISË

Iso polifonia dy zërëshe:

Formë e isopolifonisë shqiptare. Enci. E konsideruar si forma më e thjeshtë e polifonisë shqiptare, isopolifonia 2 zërëshe është e përhapur në të gjithë jugun e Shqipërisë. Iso-polifoninë dy zërëshe (marrje dhe prerje) e hasim si tek gratë ashtu edhe tek burrat.

Përhapja gjeografike prek pa dallim pothuajse të gjithë hapësirën gjeografike të përfshirë në Toskëri dhe në Labëri si rrethet e Korçës, Librazhdit, Po-

gradecit, Kolonjës, Fierit, Shpatin e sipërm të Elbasanit, Myzeqenë bregdetare, Myzeqenë e Vlorës, qytetin e Vlorës, lumi i Vlorës, fshatrat e Beratit, Mallakastër, Gjirokastër-qytet, Lunxhëri, etj. Është vëmë në dukje se polifoni me dy zëra e dy këngëtarëve këndohet, kryesisht nga gra të qytetit të Gjirokastrës, burra të fshatit Dukat të rrethit të Vlorës. Lidhur me këndimin e veçantë të dyzërëshit nga Dukati, mendohet se ndeshet më rrallë dhe ka një shtrirje hapësirnore dhe gjinore më të

kufizuar. E ndeshim këtë mënyrë ekzekutimi vetëm nga dy individë, të gratë shqiptare të Maqedonisë të zonave të Dollit, Zajazit, Kërçovës, Tetovës, etj., në Labëri vetëm në fshatin Dukat të rrethit të Vlorës dhe të ekzekutuar vetëm nga burrat, ndërsa në Toskëri në disa fshatra të Myzeqesë bregdetare dhe kryesisht në brezin e grave të reja. E ndeshim këtë lloj dyzërëshi edhe në Arbëreshët e Kalabrisë ku ka një përhapje dhe një përdorim të gjerë edhe sot e kësaj dite. Sipas

opinionit të Lorenc Antonit këngët dy zërëshe të Kërçovës do të jenë krijuar ndoshta të frymëzuara prej të kënduarit shumëzërësh të toskëve fqinjë. Megjithëse janë bërë lloj-lloj klasifikimesh duke u ndarë në variante të shumta, isopolifonia dy zërëshe mbart në përgjithësi marrëdhëniet ndërmjet *marrësisit* dhe *prerësisit*, tipar thelbësor ky i isopolifonisë jugore, si në Toskëri dhe në Labëri, pavarësisht sasisë së njerëzve në interpretimin e saj. E rëndësishme të theksohet është

të se si tip qëndror është dy zërëshi me ison e fshehur përgjatë zhvillimit melodik të zërave. Për mendimin tim, dy zërëshi në përgjithësi nuk duhet konsideruar si një stad i parë i shumëzërëshit polifonik. Theksoj faktin se sipas meje isopolifonia nuk ka patur ndonjë zhvillim historik në formimin e tipareve të saj me dy, tre apo katër zëra por gjithmonë ka funksionuar si një lëndë e përbashkët e cila ka qenë thërmuar në këto trajta të klasifikuar si të tilla. Prandaj dy zërëshi iso-

polifonik në dukje është një dyzërësh, por nga funksionet që kryen është një "tre zërësh i fshehur", i "reduktuar" në dy zëra. Ajo ç'ka tjetër duhet thënë është e lidhur me faktin se nuk mund të ketë klasifikime të dyzërëshit nisur vetëm nga konstatime melodike, apo qoftë edhe nga preferencat ritmike të këngëve. Nuk mund të ketë dy zërësh jashtë konceptit të iso-pedalit, veçori e cila përfshin gati të gjitha format e ekzistencës së dyzërëshit në muzikën isopolifonike jugore.



# ISO-POLIFONIA

ENGLISH  
PAGE 8

Consult of albanian music and the albanian section of CIOFF edition  
Realize in collaboration with "Dita JUG" newspaper staff

## Mak Albania buys biggest hotel in Saranda

Mak Albania, the Albanian subsidiary of Kharafi Group of Kuwait, is reported to have bought for EUR12 million the only five star hotel in Albania, Hotel Butrinti, in the city of Saranda south of Albania. The daily Gazeta Shqiptare in Tirana published the news after its previous owner, Gaze Demi, had reported about the sale of the hotel. The seven-story hotel had seen a EUR4 million reconstruction investment after being purchased about US\$ 800,000 back in 1999, according to the newspaper. Mak Albania office in Tirana has not yet confirmed the news. Mr. Demi had started direct negotiations with Mak Albania as well as with the giant chain of Hilton Hotels, before signing his contract with the Kuwaiti group. Mak Albania is recognized as the largest foreign investor in Albania. Its operations extend to the sectors of air transport, construction and hotels. Hotel Butrinti is located in the city of Saranda, in Albania's southern edge, only a few kilometers from the Greek island of Corfu. According to Albanian statistics, about 20,000 foreign tourists visit Albania every year through the port of Saranda to visit the ancient city of Butrinti, however almost none of them are reported to stay over to spend the night. **Silke Liria**

## The Albanian resource which are proclaim as Masterpiece of the Heritages of Humanity



They are three Albanian resource which are proclaim as Masterpiece of the Heritages of Humanity: the antic city of Butrinti, the city off Gjirokastra and Iso-Polyphony.

1. The antic city of Butrinti is proclaim part of masterpiece of UNESCO in 1992. This city is in south west part of Albania. The legend said that this city was build in the IV century before Christ. In roman epoch the city was a colony founded from August emperor. During the recent antiquity the city was spreading all over Vivar canal. They are o lot of old buildings and from archaeological expeditions are found o lot of interesting things which shows for a intensive life.



2. Gjirokastra, for unrepeatable values is proclaimed heritage center in 1961. For this values is proclaimed Masterpiece of the Heritages of Humanity in 2005. The city was build century before Christ, and the castle in the 13-th century. The functioning of the castle was to protect the people. The city was found in 14-th century and was spreading around the castle. In that time become one of the important city of the regions. The quarter of Gjirokastra are spread on broken land, every house has e special architecture. The category of the monuments are classify: the castle, people house, Bazaar and cult monuments.



3. Albanian Polyphony music can separate in to different kinds: the music in the North of country and the other one the music in the south. The dossier prepared from Heritages Culture Direction in TCYSM was based in all proclaim standards from UNESCO applications. Lots of documents in English language, literature, and materials become parts of this dossier. The dossier for UNESCO was prepared with Iso-Polyphony music which is play in the south of Albania. After positive confirmations from UNESCO we can say that Albanian culture is become the first and very importance factor for European integrations.

## In this number you will read:

From Dr. Eno Koço

Senior Teaching Fellow in the School of Music University of Leeds

Neço Muka, the legend of himariot songs

From Dr Vaso Tole

Heritages Culture Director in TCYSM

Benjamin Kruta, a life with Iso Polypony

From Spiro Shituni

Albanian folk music, a real artistic value

From Sejmen Gjokoli

The magic off Albanian Polyphony

From Sinan Ahmeti

The profile of "Voice of nightingale" group

## "Odyssey and the sirens"

Wrote by Vasil.S Tole  
Publish from "Uegen"  
Printing-House  
Redactor: Ledi Shmaku  
This book was published with the support of Albanian fund for the monuments.



## NEW PUBLICATIONS FOR ISO-POLYPHONY


"Full Moon outside"  
Wrote by Maliq Lila  
Publish from "Toena" Printing-House  
Redactor: Petrit Rukas



"Lunxhiot songs"  
Wrote by Kleanthi Dedi, Mina Koçi  
Publish from "Argjiro" Printing-House  
Redactor: Arben Bllaci



"...Iso guys!"  
Wrote by Timo Merkuri  
Publish from "Milosao" Printing-House  
Redactor: Thoma Nika  
Reviewer: Jona Merkuri



"Verse throughout the years"  
Wrote by Engjell Fino  
Publish from "Argjiro" Printing-House  
Redactor: Luan Fino



"The songs which migrate throughout the centuries"  
Wrote by Fitim Çausi  
Publish from "Toena" Printing-House  
Redactor: Nexhat Myftiu  
Reviewer: prof.dr. Adriatik Kallulli, prof.dr. Bardhosh Gaçe, prof.dr. Valter Memisha  
Adviser: Roland Çene, Haxhi Dalipi

